VENDIM
Nr. 226, datë 21.3.2017

PËR FINANCIMIN E KOSTOS SË MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE QË ZBATOHEN NGA FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

(Ndryshuar me vendimin nr. 161, datë 17.3.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 50 e 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", dhe të neneve 6, pikat 2, shkronja "a", e 4, dhe 8, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e kostos së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të cilat nuk e kanë të parashikuar këtë kosto në marrëveshjet përkatëse të financimit. Kjo kosto është në masën 5% mbi vlerën totale të financimit të çdo programi/projekti.

1/1. Financimin e kostos së menaxhimit të projekteve, në kuadër të programit të rindërtimit që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të cilat nuk e kanë të parashikuar këtë kosto në marrëveshjet përkatëse të financimit. Kjo kosto është në masën 3% mbi vlerën totale të financimit të çdo programi/projekti

2. Për vitin 2017, kjo kosto është jo më shumë se 173 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë) lekë dhe përballohet nga zëri i kostos lokale të miratuar në buxhetin e vitit 2017, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama